



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 19 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, nenit 36 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtar Publik, nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Rregullores Nr. 03/2022 për Praktikantë në Sistemin Prokurorial lidhur me procedurën për rekrutim të praktikantëve vullnetarë pa pagesë, për periudhën një (1) vjeçare në sistemin prokurorial të Kosovës, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpallë këtë:

K O N K U R S
Nr. 01/2025

Për praktikant vullnetar pa pagesë, për periudhën një (1) vjeçare, si në vijim:

NR.	NJËSIA	NUMRI I PRAKTIKANTËVE	KUALIFIKIMI
1.	Sekretariati i KPK-së	3	Diplomë Universitare Fakulteti Juridik
2.	Sekretariati i KPK-së	2	Diplomë Universitare Fakulteti Ekonomik
3.	Prokuroria e Apelit	5	Diplomë Universitare Fakulteti Juridik
4.	PTH Prishtinë	20	Diplomë Universitare Fakulteti Juridik
5.	PTH Ferizaj	10	Diplomë Universitare Fakulteti Juridik
6.	PTH Prizren	10	Diplomë Universitare Fakulteti Juridik
7.	PTH Gjilan	5	Diplomë Universitare Fakulteti Juridik
8.	PTH Mitrovicë	10	Diplomë Universitare Fakulteti Juridik
9.	PTH Mitrovicë	1	Diplomë Universitare Fakulteti Ekonomik
10.	PTH Pejë	6	Diplomë Universitare Fakulteti Juridik
11.	PTH Gjakovë	4	Diplomë Universitare Fakulteti Juridik
12.	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihme Viktimave Prishtinë	2	Diplomë Universitare Fakulteti Juridik
13.	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihme Viktimave Gjilan	1	Diplomë Universitare Fakulteti Juridik
14.	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihme Viktimave Ferizaj	1	Diplomë Universitare Fakulteti Juridik

15.	Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave Pejë	1	Diplomë Universitare Fakulteti Juridik
16.	Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave Gjakovë	1	Diplomë Universitare Fakulteti Juridik
17.	Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave Prizren	1	Diplomë Universitare Fakulteti Juridik
18.	Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave Mitrovicë	1	Diplomë Universitare Fakulteti Juridik
GJITHSEJ:		84	

Detyrat kryesore të praktikantit/es:

- Ndhmon prokurorët si dhe stafin e sistemin prokurorial në kryerjen e detyrave si dhe kryen pune të tjera në koordinim me zyrtarët e prokurorisë dhe Sekretariatit të KPK-së.
- Përbahet rregullave të brendshme të sjelljes, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në vijueshmëri, orarin e punës, kodin e veshjes dhe konfidencialitetin.
- Në përputhje me legjislacionin në fuqi duhet të gëzojnë të drejtën për pushim ditor, pushimin vjetor, festat zyrtare dhe mbrojtjen nga orët e tepërta të punës.
- Praktikanti duhet të ketë mundësinë që të aftësohet në aspektin profesional në kuadër të detyrave dhe përgjithësive të cilat i janë ngarkuar.
- Përgatitjen e raportit gjashtë mujor dhe në fund të praktikës, ose sipas kërkesë së mbikëqyrësit me angazhimet e kryera.
- Kryen edhe detyra tjera të caktuara nga prokurori dhe zyrtarët e sistemit.
- Përfshihet praktikantët të cilët janë të fushave tjera, siç janë praktikant në financa, teknologji informative, administratë, burime njerëzore si dhe shërbime të tjera të përgjithshme detyrat përcaktohen nga udhëheqësit e njësive përkatëse brenda Prokurorit të Shtetit dhe në Sekretariatit të KPK-së sipas nevojës.
- Për punën e tyre praktikantët në Sekretariat mbikëqyren nga udhëheqësit e njësive, ndërsa në prokurori nga administratori i prokurorisë.

Kualifikimi:

- Diplomë Universitare - Fakulteti Juridik;
- Diplomë Universitare - Fakulteti Ekonomik.

Aftësitë dhe Shkathtësitë e kërkuara:

- Njohuri të procedurave administrative, etj.;
- Aftësi për përgatitjen e akteve juridike;
- Aftësi të punës me kompjuter;
- Shkathtësi komunikimi.

Dokumentet për aplikim:

- Kopjen e letërnjoftimit;
- Diploma apo certifikatë universitare;
- Certifikata e gjendjes penale.

VËREJTJE:

- Konkursi është i vazhduar pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shpalljes së lajmërimit më datën: **24.02.2025** dhe mbyllet me datë **10.03.2025**.
- Kandidatët praktikantë duhet të plotësojnë formularin standard për aplikim që është dispozicion në ueb faqen e KPK-së: www.prokuroria-rks.org

Forma e aplikimit:

- Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00 në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës/Departamenti i Burimeve Njerëzore kati IV, Rr. "Luan Haradinaj", Objekti i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, 10000 Prishtinë

- Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Departamentin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj" objekti i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.
- Aplikacionet pas skadimit të afatit të konkursit të lartë cekur nuk pranohen.